



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 1395 Prot.

Tiranë, më 06.02., 2019

**UDHËZIM**

Nr. 2, datë 06.02.2019

**“PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË  
ARSIMIT FILLOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 50 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 24 Maj 2019, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.
2. Testi është i integruar dhe përfshin lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.
3. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, fillon në orën 10.00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.
4. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor 2019”.
5. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe standardin e tyre.
6. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QShA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.
7. Institucioni Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, (IPSCAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.

8. Arkivimi i testeve bëhet pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.
9. Sektori i statistikës i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit (QVT) dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA dhe MASR.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Institucioni Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Institucionet arsimore Vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR  
  
BESA SHAHINI

